



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA

Pranuar - Primaljeto Më/Dana 01-03-2024

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetës Prilog	Vlera Vredno.
01-	110/05-		180



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 dhe kërkesa e Ministrisë për Financa, Punë dhe Transfere Nr.30-1/2024, e datës 23.01.2024, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.02.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-49932, i datës 27.12.2023 për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores "Liria" Gjilan, për një periudhë trevjeçare 2024-2025-2026

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-49932, i datës 27.12.2023 për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores "Liria" Gjilan, për një periudhë trevjeçare 2024-2025-2026.

Neni 2

Shfuqizimi bëhet me kërkesën e Ministrisë për Financa, Punë dhe Transfere Nr. 30-1/2024, e datës 23.01.2024, sepse nuk është specifikuar nënprogramin e caktuar të shpenzimeve, kategorinë e shpenzimeve dhe nuk është respektuar dispozita e Rregullores së MF-së Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdesen kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Strehimores "Liria" Gjilan;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi